



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA PRANE GJYKATES SE SHKALLES SE PARE
PERMET

Nr _____ Prot

Permet, me 06.02.2018

ANALIZA

E TREGUESVE TE PUNES
TE PROKURORISE PRANE GJYKATES SE SHKALLES SE PARE PERMET
PER VITIN 2017

Drejtuar :

PROKURORISE SE PERGJITHSHME
TIRANE

Per vitin **2017** nga ana jone eshte kryer nje analize e detajuar veprimtarise dhe treguesve te pergjithshem te Prokurorise prane Gjykates se shkalles se pare Permet, ne ushtrimin e ndjekjes penale ne fazen e hetimit paraprak dhe ne fazen e gjykimit, si dhe kryerjen e detyrimeve te tjera te parashikuara ne ligj, nga prokuroret dhe oficeret e policise gjyqesore.

Bazuar ne te dhenat qe do t'ju paraqisim dhe analizojme ne kete material, evidentohet se gjate vitit **2017**, Prokuroria prane Gjykates se shkalles se pare Permet, ka perballuar nje ngarkese pune te konsiderueshme, ne raport me vitet e kaluara.

TE DHENA TE PERGJITHSHME

Ne Prokurorine prane Gjykates se shkalles e pare Permet per vitin **2017**, jane trajtuar 233 materiale kallzimi (apo dhe me vendngjarje), jane **regjistruar** gjate ketij viti gjithsej **166** procedime penale, nga te cilat 13 kane ardhur të transferuara nga prokurorite e rretheve te tjera, me 57 persona nen hetim, 63 te pandehur dhe 10 me mase Arrest ne burg .

Ne regjistrat perkates te kesaj Prokurorie, gjate vitit **2017**, jane regjistruar edhe **57** materiale per **mosfillim** .

Nga viti **2016**, jane **mbartur** gjithsej **68** procedime penale, **6** pandehur dhe **3** persona nen hetim, prej te cileve **1** i arrestuar.

NE TOTAL :

Ne vitin **2017**, duke perfshire tashme edhe ceshtjet e mbartura, eshte ushtruar ndjekja penale ne hetimin paraprak per **234 procedime penale** , nga këto **46** te pushuara ,**51** te pezulluara , **49** derguara gjyqit dhe **11** transferuar per kompetence ne prokurori te tjera,77 mbeten ne hetim ,

Ne ceshtjet per te cilat eshte ushtruar ndjekja penale gjate vitit **2017**, jane hetuar gjithsej **234** , nga keta 63 persona **te pandehur** dhe **57** persona **nen hetim**.

Nder personat e hetuar, **18** persona jane hetuar me masen e sigurimit **arrest ne burg**, kurse te tjeret jane hetuar me masa te ndryshme sigurimi.

Rezulton se ne vitin **2017**, , jane paraqitur ne total **233** nga te cilat 34 kallëzime nga shtetasit, 181 referime nga policia e shtetit, 9 referime me vëndngjarje, 8 nga nënpunës publik dhe 1 filluar kryesisht nga prokurori .

Lidhur me gjendjen e kriminalitetit gjate viti 2017 eshte vene re nje rritje e veprave penale të Kreut te Dyte (pjesa e posacme) te Kodit Penal, e konkretisht, krime kunder personit me 65 kallezime . Eshte per tu theksuar se gjate ketij viti janë shtuar procedimet penale per veprat penale që kanë të bëjnë me dhunën në familje, perndjekjen etj. Vlen per tu thkesuar se ne pamje te pare duket sikur ka nje rritje te ketyre veprave penale, por mendojme se kjo rritje e numrit te procedimeve penale per vepra te tilla ka te beje me shume me evidentimin e tyre nga ana e organeve ligjzbatuese si dhe me rritjen e besimit te qytetareve tek keto organe duke i bere ata te ndergjegjshem ne ushtrimin e te drejtes dhe detyrimit ligjor per ti kallzuar ne cdo moment keto lloj veprash penale.

Në lidhje me Kreun e Tretë te Kodit Penal, “Veprat penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike”, janë regjistruar 97 kallezime penale ku konstatohet se ka një rritje nga një vit më parë.

Kreu 4 “Vepra penale kunder mjedisit” - 8 kallezime

Kreu 8 “Vepra penale kunder autoritetit te shtetit “ - 58 kallezime

Kreu 9 “ ,”Vepra penale kunder Drejtesise “ 5 kallezime

TENDENCA E KRIMINALITETIT SIPAS MOSHËS, VËNDBANIMIT, ARSIMIT DHE SEKSIT.

Ne procedimet penale te regjistruara gjate vitit 2017 janë marre të pandehur 63 persona dhe nen hetim **57** te tjere , të cilët janë mbi 18 vjec (pasi procedimet me te mitur jane kompetence e seksionit per te mitur ne Prokurorinë prane Gjykates se

shkalles se pare Gjioraster), nga keta mbi **50 %** pjesa me e madhe jane banore te Komunave ,me arsim 9 klase ,2 te pandehura jane femra .

TE DHENA PER FAZEN E HETIMIT PARAPRAK VEPRIMTARIA PROCEDURALE NE FAZEN E HETIMIT PARAPRAK

Per vitin **2017**, treguesit e arrestimeve ne flagrance dhe ndalimeve, te kryer ndaj shtetasve te dyshuar per kryerjen e veprave te ndryshme penale, paraqiten si me poshte :

Jane **arrestuar ne flagrance** nga policia gjyqesore **35** shtetas,
Jane **ndaluar** nga policia gjyqesore **16** shtetas,

Eshte kerkuar ne gjykate vleresimi i arrestimit ne flagrance apo ndalimit per **51** persona, nder te cilet gjykata ka vleresuar te ligjshem **47** dhe te paligjshem **4** te tilla ,si dhe eshte kerkuar caktim mase sigurimi per **5** persona . Ne lidhje me keto te fundit theksojme se paligjshmeria sipas gjykates ka konsistuar ne intepretimin e kohes se kapjes se personit me procesverbalin e arrestimit ne flagrance, te cilat kane difference shpesh here midis tyre ne 1 apo dy ore.

Edhe ne vitin **2017**, ashtu sikurse edhe ne vitet e kaluara numri i rasteve kur arrestimi ne flagrance apo ndalimi, i personave te dyshuar per kryerjen e veprave te ndryshme penale, eshte vleftesuar i paligjshem nga gjykata eshte i paperfillshem. Kjo lidhet edhe me nivelin e policise gjyqesore dhe respektimin me korrektese te kriterëve procedurale per keto raste, si dhe me mbajtjen e komunikimit te vazhdueshem me prokurorin ne momentin e arrestimit ne flagrance apo te ndalimit.

Numri i ulet i rasteve kur arrestimi ne flagrance apo ndalimi eshte vleftesuar i paligjshem nga prokuroret apo gjykata, cmojme se eshte nje tregues pozitiv ne kete drejtim.

Nga ana tjeter nga prokuroret eshte treguar kujdesi i nevojshem lidhur me masat e sigurimit te caktuara ndaj personave qe dyshohen per kryerjen e veprave te ndryshme penale. Krahas respektimit te detyrimeve procedurale penale, per kushtet dhe kriteret e aplikimit te masave te sigurimit, vemendje e vecante eshte treguar ne vecanti tek kerkesat lidhur me masen e sigurimit "**arrest ne burg**". Eshte synuar qe kjo mase sigurimi te kerkohet vetem kur cdo mase tjeter eshte e papershtatshme, nga njera ane dhe nga ana tjeter te mos caktohet nje mase e tille sigurimi kur te dhenat lidhur me akuzen nuk jane te konsoliduara.

Per vitin **2017**, treguesit e kerkesave te prokurorit per masat kryesore te sigurimit, paraqitet si me poshte vijon :

-Nga **prokurori** eshte kerkuar ne gjykate per **22** persona caktimi i mases se sigurimit “**arrest ne burg**”, nderkohe qe **gjykata** e ka caktuar ate mase sigurimi ndaj **18** personave,

-Nga **prokurori** eshte kerkuar per **4** persona caktimi i mases se sigurimit “**arrest ne shtepi**”, nderkohe qe **gjykata** e ka caktuar ate mase sigurimi ndaj **3**personave,

- Nga **prokurori** eshte kerkuar per **28** persona caktimi i mases se sigurimit “**detyrim per paraqitjen ne policine gjyqesore**”, nderkohe qe **gjykata** e ka caktuar ate mase sigurimi ndaj **30** personave,si dhe 2 te tjere jane lene me mase sigurimi “Garanci pasurore” dhe 3 te tjere me mase mjekesore .

Nga ana e prokurorise eshte apeluar ne 2 raste ndaj mases se sigurimit te caktuar nga Gjykata,ndaj shtetasve Safet Spahiu dhe Arben Dosti , per te cilat eshte kerkuar arrest me burg nga Prokurori ,dhe eshte caktuar “Detyrim per paraqitje “ nga Gjykata , vendime te cilat jane lene ne fuqi nga Gjykata e Apelit Gjirokaster. Sa me siper konstatojme se midis kerkesave per vleftesimet e arrestit ne flagrance dhe ndalimit nga njera ane e caktimit te masave te ndryshme te sigurimit nga ana tjeter dhe vendimeve te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Permet me kete objekt, ka nje diference te vogel, c’ka tregon se kerkesat tona per masen e sigurimit kane qene te pershtashme dhe te bazuara ne ligjin procedural penal ose e kunderta gjykata nuk ka disponuar me vendime te bazuara ne prova dhe ne ligj.

CESHTJET E MOSFILLUARA

Ne vitin **2017**, jane **mosfilluar** gjithsej **57** procedime penale. Ne te gjitha rastet kur procedimet penale jane mosfilluar, pervec menyres korrekte dhe te bazuar ne ligj te vendimmarrjes dhe kohes se marrjes se saj, eshte respektuar me korrektese edhe detyrimi ligjor, per njoftimin e vendimit personave te interesuar, duke respektuar te drejten e tyre per te ushtruar ankimin ne gjykate.

Nga ana tjeter, kur nga materiali fillestar nuk kane rezultuar elemente te mjaftueshem per fillimin e ceshtjes, prokuroret dhe oficeret e policise gjyqesore kane kryer verifikimet paraprake, duke synuar respektimin e afatit kohor 15 ditor, pas te cilit, nese nuk siguroheshin te dhena te tjera, procedimet jane mosfilluar.

Vendimet e procedimeve penale te mosfilluar, jane **ankimuar** ne gjykate nga te interesuarit ne 4 raste. Nga keto :

- Jane lene ne fuqi 3 vendime te mosfillimit
- 1 eshte shfuqizuar nga gjykata

Sa me siper nisur nga numri i paket i ankimeve te vendimeve te mosfillimit konstatohet se vendimet e marra nga prokuroret kane qene te bazuara ne ligj dhe kane qene kryesisht per veprat penale te parashikuara nga neni 90 i K.Penal,te cilat ndiqen kryesisht ne gjykate, vdekje natyrale .

Ne numrin e me te ulet te mosfillimeve te procedimeve penale per vitin **2017**, ne krahasim me vitin **2016**, ka ndikuar vec te tjerave edhe paraqitja ne prokurori kryesisht nga ana e policise gjyqesore e materialeve te cilat : se pari nuk jane referuar per veper penale konkrete nga policia gjyqesore dhe se dyti edhe ne ato raste kur eshte referuar per veper penale konkrete, ka rezultuar se nuk ka patur elemente te veprave penale dhe materiali nuk duhej referuar, ose edhe ne rastet e veprave penale qe ndiqen me ankim direkt ne gjykate nga te demtuarit akuzues.

CESHTJET E TRANSFERUARA

Gjate vitit **2017**, jane **transferuar** gjithsej **11** procedime penale, me 15 persona nen hetim..

CESHTJET E PUSHUARA

Gjate vitit **2017**, jane **pushuar** gjithsej **46** procedime penale, nga te cilat :

- 20 procedime per **mungese te provave** te mjaftueshme,
- 26 procedime per shkaqe **te tjera procedurale**, nder me kryesoret e te cileve heqjet dore nga te demtuarit per veprat penale qe ndiqen mbi ankim.
- Me hyrjen en fuqi te Kodit te Ri ne 1 gusht 2017 ,jane paraqitur ne gjykate 13 kerkesa per per pushim ceshtje/akuze , me 23 persona nen hetim ,

Eshte **pushuar** ndjekja penale per 23 persona ne hetim ose te pandehur, per te cilet eshte paraqitur kerkese ne gjykate per miratimin e vendimit te pushimit te ceshtjes ose akuzes .

Sa me siper eshte tregues i kujdesit te vecante qe kane treguar prokuroret qysh ne momentin fillestar te hetimeve qe, nga njera ane, te mos caktohet masa e sigurimit “arrest ne burg” pa patur prova evidente per vertetimin e akuzes dhe nga ana tjetere, qe te mos merreshin persona te pandehur pa patur nje baze te mjaftueshme te te

dhenave qe do te siguronin mbrojtjen e akuzes deri ne gjykim. Ketij qellimi i ka sherbyer edhe vijimi i praktikes per diskutimin paraprak mes prokuroreve te ceshtjes dhe drejtuesit te Prokurorise, ne momentin e caktimit te mases se sigurimit.

Per te gjitha rastet e pushimit te akuzes ose ceshtjes me persona te arrestuar jane kryer analiza dhe diskutime midis drejtuesit dhe prokuroreve e oficerëve te policise gjyqesore qe kane kryer hetimet.

Nuk ka patur rasje rast te pushimit te ndjekjes penale apo te ceshtjes me persona te arrestuar ne burg .

CESHTJET E PEZULLUARA

Gjate vitit **2017**, jane **pezulluar** gjithsej **51** procedime penale, të gjitha këto per shkak se nuk eshte bere e mundur te zbulohet autori i vepres penale.

Bazuar ne te dhenat vjetore, pjesa me e madhe e procedimeve penale te pezulluara lidhet me vepra penale kunder pasurise dhe sidomos me vepren penale te vjedhjes. Kjo mjafton per te arritur ne perfundimin se puna e strukturave perkatese jo vetem per zbulimin, por edhe per parandalimin e kesaj vepre penale nuk eshte ne nivelin e duhur, mangesi qe eshte evidentuar edhe ne analizen e punes per vitin **2017**.

. Eshte e domosdoshme qe per zbulimin e autoreve te ketyre veprave penale, qe perben nje shqetesim real per komunitetin qe perfshin qarku i Permetit, te gjitha strukturat policore, si ato per parandalimin dhe per hetimin e ketij krimi te organizojne nje pune te mirefillte profesionale, ku krahas perdorimit te mjeteve klasike per sigurimin e provave te perdorin edhe mjete te posacme per kerkimin e tyre.

Nga prokuroret eshte kerkuar ne vazhdimesi, qe te tregohet vemendja e duhur me qellim qe pezullimi i procedimit te vendosej pas kryerjes nga policia gjyqesore te gjithë veprimeve hetimore paraprake te mundshme. Pavaresisht nga sa me siper, eshte me vend te kerkohet nje vemendje me e madhe nga oficeret e policise gjyqesore, te sherbimeve dhe seksionit, gjate kryerjes se veprimeve te paperseritshme te hetimit paraprak, si kqyrja e vendit te ngjarjes, evidentimi i te gjitha gjurmeve dhe sendeve te gjetura aty, marrja e provave materiale, me qellim qe numri procedimeve penale te kesaj natyre, te vije duke u zvogeluar.

PROCEDIMET PENALE TE DERGUARA PER GJYKIM

Ne vitin **2017**, jane **derguar per gjykim** gjithsej **49** procedime penale, me **57** persona **te pandehur,nga te cilat 3** jane me gjykim te drejtperdrejte .

Nder te pandehurit, **10** prej tyre kane qene me mase sigurimi **arrest ne burg**, kurse pjesa tjeter jane ndjekur me masa te ndryshme sigurimi.

Me hyrjen ne fuqi te Kodit te Ri Penal nga shtatori –dhjetor 2017 jane derguar 21 kerkesa per gjykim te ceshtjeve, kme 26 te pandehur, ku 13 nga ketpo jane miratuar per kalimin ne gjyq ,1 eshte derguar per gjykim ne gjykate kompetente dhe te tjerat jane ne shqyrtim.

Procedimet penale te derguara per gjykim perbejne numrin prej rreth **46.6 %** te procedimeve penale te perfunduara, pa llogaritur ne kete perqindje procedimet penale te mbartura per vitin **2017**.

Procedimet penale me autore konkrete dhe me prova te mjaftueshme, kane qene prioritet i punes sone edhe gjate vitit **2017**. Prokuroret kane treguar kujdes qe per ato procedime ne te cilat ka patur nje baze te mjaftueshme te dhenash hetimore paraprake dhe me te pandehur te arrestuar, autoret te dergoheshin para gjykates brenda afatit **3** mujor.

Ndonese, sikurse u permend edhe me siper, arrestimi i personave eshte kerkuar vetem kur cdo mase tjeter ka rezultuar e paefektshme, eshte treguar vemendja e duhur qe per veprat penale me rrezikshmeri te theksuar shoqerore, si ato kunder jetes se personit, korrupsionit, ato kunder pasurise, ne fushen e mbajtjes dhe trafikimit te narkotikeve, mbajtjes apo perdorimit te armeve te zjarrit (sidomos ne ambjente publike), aksidenteve automobilistike me pasoja te renda per jeten apo shendetin e personave, dhunes ne familje, drejtimit te mjetit ne menyre te parregullt, vjedhjes se energjiise elektrike, ndertimeve te paligjshme etj, hetimet ndaj autoreve te derguar per gjykim te kryheshin ne gjendje arresti. Lidhur me masat e sigurimit te kerkuara per keto vepra, pothuajse ne te gjitha rastet edhe gjykata i ka miratuar kerkesat e prokurorit per caktimin e masave te sigurimit. Edhe ne ato rast kur gjykata ka vendosur ndryshe nga ana jone eshte ushtruar ankim.

Pervoja e siguruar gjate vitit te kaluar ne hetimin e veprave penale teper te renda, tregon se rezultatet ne drejtim te zbulueshmerise se autoreve jane te larta aty ku ka nje bashkepunim te ngushte te prokurorit me strukturat e policise se shtetit, nderhyrje te drejtperdrejte te prokurorit ne veprimet e para hetimore dhe nje kontroll efikas dhe periodik te te gjitha veprimeve nga policia gjyqesore.

NE TOTAL, per periudhen njevjecare te vitit 2017 (pa perfshire edhe ceshtjet e mosfilluara) , jane **perfunduar 157** procedime penale me **120** persona, nder te cilet **63 te pandehur** dhe **57** persona **nen hetim**. Nga personat per te cilet

jane perfunduar hetimet paraprake, jane hetuar me masen e sigurimit “**arrest ne burg**”, **5** persona.

Jane **mbartur** ne hetim per vitin **2018, 77** procedime penale,

Kemi një rritje të numrit te procedimeve penale te mbartura, ne **raport me vitin e kaluar**, pasi sic e theksuam edhe me lart ka patur nje numur madh procedimesh ne krahasim me vitin 2016 , si dhe rritje te numrit te kallzimeve.

Por nga ana tjeter, per Prokurorine prane Gjykates se shkalles se pare Permet ka qene nje tregues jo shume i kenaqshem ai i shpejtesise ne hetimin paraprak, qe pasqyrohet si ne numrin e larte te procedimeve penale te mbartura, ashtu edhe ne numrin e larte te zgjatjeve te afatit te hetimit paraprak. Megjithate vlen të theksohet se pervec pergjegjesise se prokuroreve dhe oficerëve ne mbartjen e ketij numri jo te vogel procedimesh penale per vitin **2017**, ne te ka ndikuar edhe

- Levizjet e shpeshta te Oficerëve te policise Gjyqesore ne Komisariate dhe Drejtorine e Policise Gjirokaster
- Mosfunksionimi i Zyres sde Rregjistrimit te Pasurive te Palujtshme, e cila ka qene e pezulluar per disa muaj

Gjate vitit **2017**, por duke perfshire edhe ceshtjet e mbartura nga vitet e kaluara, u zgjaten afatet e hetimit paraprak

- Per 12 procedime penale, ku kane qene **4** persona te pandehur ose nen hetim, **3** prej te cileve te arrestuar ,u zgjaten hetimet deri ne 3 muaj :
- Per 2 procedime penale me 3 te pandehur ,3 arrest ne burg u zgjaten hetimet nga 3 – 6 muaj
- Per 3 procedime penale pa persona u zgjaten hetimet nga 6-9 muaj dhe
- Per 2 procedime penale mbi 9 muaj .

Pikerisht permiresimi i ketij treguesi te hetimit paraprak ka qene nje nder prioritetet e drejtuesit te prokurorise dhe zevendesit te tij, duke marre nje numer masash qe kane te bejne me :

- angazhimin me te madh te prokuroreve ne kontrollin e shpeshte te kryerjes se veprimeve te deleguara,
- kryerjen e takimeve te vecanta me strukturat e policise gjyqesore, per ti motivuar dhe kontrolluar ato per kryerjen e detyrimit procedural qe lidhet me afatin e hetimit,

- pjesemarrja aktive e drejtuesit te prokurorise dhe zevendesdrejtuesit ne kontrollin ne dinamike te procedimeve penale ne fazen e hetimit paraprak, nepermjet kontrollit periodik, me qellim evidentimin e respektimit te afateve te hetimit, etj.

Gjate vitit **2017**, treguesit e pergjithshem te volumit dhe cilesise se punes se kryer nga prokuroret, duke perfshire edhe ceshtjet e mbartura nga vitet e kaluara, paraqiten si me poshte :

1. Drejtuesi e Prokurorise, z. Hysen Keta per periudhen shtator 2017 e ne vazhdim , ka trajtuar **77** procedime penale (pervec mosfillimeve) nga te cilat :

- 6** procedime penale i ka **mosfilluar**,
- 5** procedime penale i ka **pezulluar**,
- 7** procedime penale i ka **pushuar**,
- 14** procedime penale i ka derguar per **gjykim**,
- 1** procedim penal transferuar
- 50** procedime penale i ka ende **ne hetim**.

2. Prokurori Asllan Barjamaj per periudhen Janar –gusht 2017

Gjithsej ka trajtuar **46** procedime penale , (pa mosfillimet)nga te cilat :

- 15** procedime penale i ka **mosfilluar**,
- 14** procedime penale i ka **pezulluar**,
- 16** procedime penale i ka **pushuar**,
- 12** procedime penale i ka derguar per **gjykim**,
- 4** procedime penale i ka **transferuar**,

3.Prokurore Silvana Pani

Gjithsej trajtuar **111** procedime penale, (pa mosfillime) nga te cilat :

- 36** procedime penale i ka **mosfilluar**,
- 32** procedime penale i ka **pezulluar**,
- 23** procedime penale i ka pushuar,
- 23** procedime penale i ka derguar per **gjykim**,
- 6** procedime penale i ka **transferuar**,

27 procedime penale i ka ende **ne hetim**.

Ne lidhje me ngarkesen e punes per Oficeret e Policise Gjyqesore, vlen te permendet puna e Oficerit te Pol Gjyqesore te Prokurorise Agron Nakollari, i cili ka punuar me pergjegjesi dhe profesionalizem duke perballuar nje ngarkese te konsiderueshme pune.

Eshte per tu theksuar gjithashtu se nga ceshtjet e derguara per gjykim ne vitin 2017 , jane marre 4 pafajesi ,1 per vepren penale te parashikuar nga neni 130 /a /1, e cila u shfuqizua nga Gjykata e Apelit Gjiorokaster dhe i pandehuri u deklarua fajtor; 3 pafajesi per vepren penale te parashikuar nga neni 186 i K.Penal ,te cilat jane lene ne fuqi nga Gjykata e Apelit Gjirokaster .

Te gjithë keto tregues, jane rezultat i bashkepunimit te mire mes faktoreve te njesise, takimeve te vazhdueshme per rritjen e pergjegjshmerise dhe profesionalizmit te prokuroreve dhe oficereve pergjate ushtrimit te detyres se tyre.

Nderkohe qe eshte rritur cilesia e hetimeve , duhet bere edhe me teper ne drejtim te rritjes se shpejtesise ne hetim. Numri i dosjeve te mbartura ne hetim vazhdon te jete relativisht i larte, mbartje e cila nuk justifikohet gjithmone me rritjen e ngarkeses por edhe me zvarritje te hetimeve nga prokuroret .

TE DHENA PER FAZEN E E EKZEKUTIMIT

Gjatë vitit **2014**, janë nxjerrë gjithsej 32 **urdhëra ekzekutimi**, nga këto **4** urdhëra janë me **burgim**, **20** me **pezullim burgimi**, **2** me **gjobë**, dhe **6** urdhëra sipas nenit 63 (pune ne interes publik) .

FAZA E GJYKIMIT TE PROCEDIMEVE

Gjate vitit **2017** kane qene 10 rastet kur prokuroret kane **apeluar** vendimin e Gjykates lidhur me **vendimin perfundimtar** per shkaqe te ndryshme, si pafajesi, ndryshim te cilesimit ligjor te vepres penale, apo llojet e masat e denimit te gjykuara si te papershtatshme nga prokurori.

Per fazen e gjykimit nga ana e jone i eshte kushtuar rendesi sigurimit te provave te mjaftueshme per te vertetuar fajesine e te pandehurve, si dhe diferencimi i llojit e mases se denimit ne varesi te vepres penale te kryer.

Keshtu per veprat penale me rrezikshmeri te theksuar shoqerore si ato kunder jetes se personit, vjedhjet e cilesuara, veprat penale te mbajtjes apo trafikimit te droges narkotike etj, kerkesat tona per llojin dhe masen e denimit kane qene te larta. Po i tille ka qene edhe qendrimi yne lidhur me kerkesat per caktimin e masave te sigurimit.

Lidhur me fazen e gjykimit eshte per tu theksuar se kane perfunduar me sukses disa nga procedimet penale qe lidhen me vepra te renda penale kunder personit, te kryera ne rrethin e Permetit.

RAPORTET ME INSTITUCIONET E TJERA

Gjate ketij viti jane mbajtur raporte korrekte me institucione te tjera, ne zbatim te ligjit procedural dhe atij organik per Prokurorine. Ne keto marredhenie rolin kryesor e zene ato qe lidhen me :

- **Prokurorine e Pergjithshme**, si institucioni epror,
- **Strukturat e policise se shtetit** dhe institucionet e tjera qe kane sherbime te policise gjyqesore, per bashkepunimin qe lidhet me fazen e hetimit paraprak te procedimeve,
- Me **Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Permet**, per fazen qe lidhet me perfaqesimin e akuzes ne gjykim,
- Me **Prokurorine e Apelit Gjirokaster** , per fazen qe lidhet me perfaqesimin e akuzes ne ceshtjet e ankimuar,
- Me institucione te tjera ne **nivel lokal**.

Raportet me Prokurorine e Pergjithshme.

Gjate gjithë vitit 2017 ka patur nje raportet shume te ngushte bashkepunimi me te gjitha drejtorite dhe sektoret e Prokurorise se Pergjithshme. Permiresimi i parametrave procedurale te Prokurorise prane Gjykates se shkalles se pare Permet, eshte i lidhur drejtperdrejt me interesimin dhe mbeshtetjen e Prokurorit te Pergjithshem dhe nga ana tjeter nje gatishmeri e plote per bashkepunimin dhe ndihmen ndaj Prokurorise sone, eshte treguar edhe nga strukturat e tjera te Prokurorise se Pergjithshme, si Drejtoria e Hetimit dhe e Kontrollit te Ndjekjes

Penale te veprave te tjera dhe te te mitureve, Drejtoria e Inspektimit dhe Burimeve Njerezore, Drejtoria e Marredhenieve Juridiksionale me Jashte, Sektori i Pergjimeve, Drejtoria Gjyqesore dhe e Mbikqyrjes te Vendimeve Penale dhe Vuajtjes se Denimit etj.

Por po kaq e rendesishme ka qene edhe ndihma e sektoreve administrative te Prokurorise se Pergjithshme, si ato financiare, te kontrollit etj, ne mbeshtetje te nevojave tona.

Raportet me strukturat e Policise se Shtetit.

Gjate vitit 2017, pervec respektimit me rigorozitet te detyrimeve ligjore dhe ne funksion te rritjes se cilesise se hetimit paraprak, eshte synuar edhe krijimi i nje raporti te ngushte bashkepunimi me te gjitha strukturat e policise se shtetit qe veprojne ne rrethin e Permetit , si dhe ne Drejtorine e Policise se Qarkut Gjirokaster .

Gjate vitit 2017, nga pikepamja formale, jane respektuar detyrimet ligjore, kur per procedimet penale qe jane regjistruar mbi bazen e materialit te referuar nga sherbimet e policise gjyqesore, hetimi prej prokuroreve eshte deleguar tek oficeret e policise gjyqesore te sherbimeve perkatese dhe ne disa raste (kur ka patur levizje te oficerëve te policise) jane ngarkuar edhe oficeret e policise te seksionit te prokurorise.

Por edhe nga pikepamja e efekteve mbi cilesine e hetimit paraprak, vleresimi yne eshte se eshte rritur niveli i hetimeve paraprake te kryera nga sherbimet e policise gjyqesore dhe rritur pergjegjshmeria e oficerëve te policise gjyqesore, ne raport me procedimin penal qe u delegohet per hetim.

Rritjes se cilesise se hetimit paraprak i ka sherbyer edhe institucionalizimi i takimeve te perbashketa periodike ndermjet drejtuesve te kesaj Prokurorie dhe drejtuesve te policise ne Rrethin e Permetit.

Per te gjitha seksionet e policise gjyqesore, te krijuara ne struktura jashte kesaj Prokurorie, jemi perpjekur te japim gjithë ndihmen e mundshme ne menyre qe te mundesojme kryerjen e detyres se tyre ne kushte sa me te mira.

Raportet me Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Permet

Raportet e kesaj zyre me Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Permet, kane qene korrekte dhe ligjore, ne perfaqesimin e akuzes ne kerkesat qe lidhen me fazen e hetimit paraprak dhe ate te gjykimit te procedimeve. Prokuroreve ju eshte kerkuar respektimi me korrektese i pjesemarrjes se tyre ne gjykim, nderkohe qe nga ana tjetër nga gjyqtaret eshte konstatuar angazhim i plote per mbarevajtjen e

gjykimeve, respektimin e solemnitetit te tij, arsyetimit dhe depozitimit te vendimit gjyqesor.

Nderkohe qe ka patur nje bashkepunim te mire me kryetarin e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Permet, ne rastet e trajtimit dhe permiresimit te problematikave te vecanta qe ndonjehere jane shfaqur per ceshtjet e lartpermendura.

- Raportet me Prokurorine e Apelit Gjirokaster .

Gjate vitit 2017 ka patur nje komunikim te vazhdueshem dhe shume te ngushte si dhe me pare me Prokurorine e Apelit Gjirokaster ne funksion te perfaqesimit sa me cilesor te akuzes ne ceshtjet e ankimuar. Ky bashkepunim, ne respektim te percaktimeve procedurale dhe udhezimit perkates te Prokurorit te Pergjithshem eshte shtrire ne diskutimin e ceshtjeve te perfaqesuara nga prokuroret e apelit. Si rezultat i nje komunikimi te tille eshte bere e mundur qe te zgjidhen plotesisht edhe disa problematika qe haseshin ne raportet mes ketyre zyrave, lidhur me perfaqesimin e akuzes ne ceshtjet e ankimuar.

Ne funksion te ketij qellimi eshte edhe organizimi i takimeve periodike, nga Drejtuesi i Prokurorise se Apelit dhe prokuroret e kesaj prokurorie, me drejtuesin dhe prokuroret e Prokurorise se Rrethit Permet, per njohjen dhe trajtimin e problemeve te hasura ne ceshtjet e ankimuar.

Nga ana jone eshte vazhduar ndjekja e praktikës qe apelimet e prokuroreve te shkalles se pare, si per masat e sigurimit dhe per vendimet perfundimtare, krahas depozitimit ne gjykate dergohen paralelisht per njoftim edhe ne Prokurorine e Apelit, po ashtu edhe njoftimi qe Prokuroria e Apelit i dergon kesaj zyre per vendimet perfundimtare ne shkallen e dyte te gjykimit, per cdo tremujor.

Raportet me Institucionet e tjera vendore.

Nga ana jone eshte treguar gatishmeri e plote per te bashkepunuar edhe me institucione te tjera si Prefektura Permet , Bashkite e Permetit dhe Kelcyres ne aktivite qe i sherbejne parandalimit te perhapjes se veprave penale, sikurse jane ato ne fushen e kultivimit dhe shperndarjes se lendeve narkotike, dhunes ne familje etj.

Ne veprimtarine e Prokurorise prane Gjykates se shkalles se pare Permet, ka qene prioritet zbatimi urdherave dhe udhezimeve te Prokurorit te Pergjithshem ne fazen e hetimit paraprak dhe gjykimit, ushtrimi ne shume raste (me shume se ne te

kaluaren) i apelit kundërshtues, njoftimi i akteve të prokurorit drejtuesit të Prokurorisë, etj.

Gjatë vitit 2017 drejtuesi i Prokurorisë ka ushtruar në çdo moment detyrimet e tyre procedurale dhe ato në zbatim të ligjit organik për drejtimin dhe kontrollin e hetimit, si dhe sigurimin e një niveli të lartë bashkëpunimi dhe bashkërendimi të punës së Prokurorisë me drejtuesit e shërbimeve policore të shtetit apo ato të institucioneve të tjera.

Gjatë vitit që lamë pas edhe personeli administrativ i kësaj prokurorie e ka kryer me korrektesë detyrën e vet, duke qenë një mbështetje e rëndësishme për prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore në përballimin e kësaj lloji ngarkese në punë dhe krijimin e raporteve të drejta me qytetëtarët, të cilëve u ofrohen shërbime administrative nga ana jonë.

Gjatë vitit 2017, buxheti financiar i Prokurorisë pranë Gjykatës së shkallës së parë Permet është administruar me rigorozitet dhe si pasojë e disiplinës financiare dhe ndihmes nga Prokuroria e Përgjithshme për zëra të vecantë të tij, nga ana e kësaj Prokurorie janë likuiduar pjesa më e madhe e detyrimeve ndaj subjekteve të tjera, ato për shpenzimet procedurale, të pagesës së mbikohes së punës etj.

Nga analizimi në teresi i elementeve që u përmendën më lart, për të ardhmen do të jenë këto prioritetet tona kryesore :

- Përfundimi në një afat sa më të shkurtër i procedimeve penale të mbartura nga viti 2016 e 2017 dhe sic u përmend më lart si objektiv kemi përfundimin e tyre në masën 90% deri në fund të muajit mars të procedimeve penale të mbartura nga viti 2018.
- Vazhdimi i ndjekjes me përparësi të procedimeve penale në fushën e krimit ekonomik dhe korrupsionit, abuzimit me detyrën nga nepësisit shtetërorë, në fushën e veprave penale kundër jetës së personit dhe moralit, pasurisë, rendit dhe sigurisë etj.
- Intensifikimi i përpjekjeve nga prokurorët për të bërë të mundur rritjen e treguesve të zbulueshmërisë së veprave penale me rrezikshmëri të lartë shoqërore, si vrasjet, vjedhjet etj, të cilat janë më të ndjeshme për komunitetin.
- Përfundimi me sukses për akuzën për fazën e gjykimit të çështjeve që lidhen me ngjarje të rënda kriminale të viteve të mëparshme, në bashkëpunim të ngushtë me shërbimet policore.
- Rritja e funksionit drejtues dhe kontrollues të prokurorit ndaj policisë gjyqësore, në seksionin dhe shërbimet e policisë gjyqësore.

- Permiresimi i organizimit, drejtimit dhe kontrollit te punes brenda organit, me qellim per t'iu pergjigjur me mire kerkesave per rritjen e cilesise se punes.
- Respektimi nga prokuroret dhe oficeret e policise gjyqesore i detyrimeve te ligjit procedural penal, urdherave dhe udhezimeve te Prokurorit te Pergjithshem.
- Rritja e profesionalizimit te prokuroreve ne hetimin paraprak, ne marrjen e vendimeve perfundimtare dhe ne mbrojtjen e akuzes ne gjykim si dhe ruajtjen e figures se paster se tyre.

**DREJTUESI I PROKURORISE
HYSEN KETA**